



**VENDIM**

**Nr. 16 Datë 30.01.2013**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURAVË PËR MODIFIKIMIN E LICENSËS SË  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE ME SERI PV10K, NR. 112,  
LESHUAR ME VENDIM TE BORDIT TE KOMISIONEREVE TE  
ERE-S NR. 110, DT. 22.12.2010 PËR SHOQËRINË “ENERGY PLUS”  
SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të “Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 10, 15 pikat 1 dhe 2 gërma “b”, pika 4 gërmat “a” dhe “b”, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, dhe nenit 18 pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 21, datë 18.03.2009, të Bordit të Komisionerëve, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.01.2013, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë “ENERGY PLUS” sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr.112, Seria PV10K, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.110, datë 22.12.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë "ENERGY PLUS" sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga “Rregullorja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma “a”** : Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma “b”** : Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për modifikimin e liçensës me nr. 112, Seria PV10K, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec "Pobreg" me fuqi 9 Mw, të shoqërisë "ENERGY PLUS" sh.p.k, të miratuar me Vendimin e Bordi i Komisionerëve Nr. 110, date 22.12.2010.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Sokol RAMADANI**